

<p style="text-align: center;">DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</p>	<p style="text-align: center;">SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</p>	<p style="text-align: center;">POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKE POVERENIČKU AGENCIJU</p>
--	---	--

ASC-09-0106

Në padinë e

Paditëse

ENG Office SHPK

Përfaqësuar nga avokati Abdylaziz Sadiku

Rruga Mulla Idrizi 31, Gjilan

kundër

E Paditur

- 1. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit**, e përfaqësuar nga UNMIK-u
Zyra për çështje ligjore, Zyra kryesore e UNMIK-ut, TSS, Prishtinë

E Paditur/Ankuese

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga Ilir Konushevci 8, Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Tapio Vanamo, kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur në ankesën e të Paditurës së dytë kundër aktgjyqimit të Trupit Gjyqes, SCC-08-0056, të datës 22 tetor 2009, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 7 tetor 2011 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet aktvendimi i Trupit Gjyqes të DHPGJS-së i datës 22 tetor 2009 (SCC-08-0056).**
- 3. Lirohet Ankuesja nga taksat gjyqësore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 3 mars 2008, Padiësja ka parashtruar një padi pranë DHPGJS-së ku ka kërkuar që të obligohet e Padiura e parë të nënshkruajë dhe të dorëzojë kontratën e shitblerjes të lidhur me Padiësen për shitjen e Newco Jugoterm nga Gjilani, që të dorëzojë asetet e ndërmarrjes së re, që Padiësja të kompensohet për dëmet materiale dhe jomateriale dhe që të lejohet të merr pjesë në tenderët e ardhshëm. Padiësja ka pohuar se është shpallë fitues nga e Padiura e parë për Newco Jugoterm, gjatë ditëve të tenderimit 21 qershor 2006 dhe 28 qershor 2006.

Padiësja fillimisht e ka parashtruar padinë kundër të Padiurës së parë. Që nga data 7 prill 2009, Trupi Gjykes e ka thirrur Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) si të Padiurën e dytë në këtë lëndë. Më parë (4 nëntor 2008), AKP-ja e ka pranuar një kërkesë, me të njëjtin numër të lëndës, për lëshimin e masës së përkohshme, gjë që është miratuar më 14 nëntor 2008.

Përmes aktgjykimit të datës 22 tetor 2009 (SCC-08-0056) Trupi Gjykes e miratoi pjesërisht padinë. Padiësja u konfirmua si ofertuese fituese e tenderit për Newco Jugoterm SHPK, e Padiura e parë u obligua që të rimbursojë dëmet materiale të Padiëses në shumë prej 16.636 euro, dhe të Padiurat u obliguan që të finalizojnë tenderin. Përveç kësaj, sipas aktgjykimit masa e përkohshme e lëshuar më 14 nëntor 2008 mbetet në fuqi deri në përfundimin e të gjitha procedurave të mëtejme që e konfirmojnë Padiësen si pronar të ndërmarrjes së re të tenderuar.

Më 17 dhjetor 2009, e Padiura e dytë (më tej në tekst Ankuesja) parashtrroi ankesë kundër aktgjykimit SCC-08-0056. Ankuesja kërkoj nga kolegji i ankesave që të ndryshojë aktgjykimin dhe që të refuzojë padinë e Padiëses si të papranueshme bazuar në atë se ajo çështje është vendosur nga DHPGJS-ja përmes aktgjykimit të mëparshëm të datës 8 gusht 2007 në SCC-06-0475.

III

Ankesa është bazuar në shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Ankuesja pohon se aktgjykimi SCC-08-0056 është në kundërshtim me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, i cili parasheh një periudhë nëntë (9) mujore për kundërshtimin e veprimeve të Agjencisë. Ankuesja gjithashtu pohon se Paditësja është njoftuar për anulimin e tenderit më datën 2 gusht 2006 përmes një shkrese të dërguar nga Drejtori i Departamentit të Privatizimit. Andaj padia, e cila është parashtruar më 3 mars 2008, është parashtruar pas periudhës nëntë (9) mujore dhe do të duhej të hedhet poshtë si e papranueshme nga Trupi Gjykes.

Ankuesja gjithashtu pohon se lënda e padisë, që është anulimi i tenderit për shitjen e Newco Jugoterm SHPK, është *res judicata* (çështje e gjykuar), kështu që nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shqyrtimi tjetër gjyqësor. Në lëndën SCC-06-0475 Shefqet Aliu, i cili kishte marrë pjesë në tender së bashku me Paditësen, ka parashtruar padi dhe AKM-ja ishte obliguar që të anulojë tenderin e privatizimit të Newco Jugoterm SHPK në të cilin Paditësja ishte shpallë ofertuesja fituese. Paditësja ka parashtruar pranë DHPGJS-së një kërkesë për shqyrtimin e aktgjykimit SCC-06-0475, e cila ishte refuzuar nga DHPGJS më 5 shkurt 2008. Andaj, pasojat juridike të aktgjykimit SCC-06-0475 janë detyruese për Paditësen. Ankuesja pohon se fakti që lëndët SCC-06-0475 dhe SCC-08-0056 janë iniciuar nga paditës të ndryshëm nuk është relevant sepse në të dyja rastet lënda e shqyrtimit gjyqësor ka qenë anulimi i të njëjtit tender. Ankuesja gjithashtu thekson se trupi gjykes nuk i ka ndjekur konkludimet e aktgjykimit të plotfuqishëm SCC-06-0475 kështu që gabimisht e ka përcaktuar gjendjen faktike dhe e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Sipas Ankueses, është pasardhësja ligjore e të Paditurës së parë, e cila ka përfunduar së ekzistuari dhe kështu që nuk ka mundur të obligohet nga aktgjykimi i Trupit Gjykues.

Në përgjigjen e saj të datës 1 prill 2010, Paditësja pohon se ankesa nuk është parashtruar me kohë dhe se të gjitha argumentet e ngritura në ankesë janë trajtuar në aktgjykimin SCC-08-0056. Paditësja kërkon nga Kolegji i Ankesave që të vërtetojë këtë aktgjykim si bazë për finalizimin e shitjes së Newco Jugoterm SHPK Paditëses.

Më 21 prill 2010, e Paditura e parë, me kërkesë të Kolegjit të Ankesave, ka parashtruar pranë DHPGJS deklaratën e saj rreth ankesës. E Paditura e parë pohon se ajo ende ekziston si entitet juridik dhe se ka të drejtë të përfaqësojë NSH-të në DHPGJS. E Paditura e parë thekson se ajo e pranon tërë aktgjykimin ndaj të cilit është ngritur ankesë. E Paditura e parë e konteston deklaratën e Ankueses se DHPGJS-ja detyrohet nga konstatimet e aktgjykimit SCC-06-0475 meqë të dyja rastet përfshijnë palë të ndryshme dhe kanë të bëjnë me informata të ndryshme lidhur me procesin e vendimit që ka paraprirë anulimin e tenderit. Andaj DHPGJS-ja nuk detyrohet nga vendimi i saj i mëparshëm SCC-06-0475.

Në kundërpërgjigjen e datës 18 qershor 2010, Ankuesja gjithashtu pohon se aktgjykimi ndaj të cilit është ngritur ankesë nuk mund të ekzekutohet meqë i referohet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), 03/L-067, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, AKP-ja është pasardhëse e AKM-së. Pala ankuese gjithashtu pohon se DHPGJS-ja është e detyruar nga vendimi i saj i mëparshëm SCC-06-0475 meqë ai i prekë të gjitha palët e përfshira në këtë çështje.

Në një parashtresë tjetër të datës 27 korrik 2010, e Paditura e parë i rithekson parashtresat e veta të datës 30 nëntor 2009 dhe 21 prill 2010.

Arsyetimi juridik

Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar. Sipas nenit 63.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, kolegji i ankesave vendosi që të refuzojë pjesën gojore të procesit gjyqësor.

Statusi i AKP-së në procesin gjyqësor

E Paditura e parë në këtë lëndë ka qenë vetëm AKM-ja të cilën Paditësja e kishte caktuar si të Paditur dhe kundër së cilës është ngritur padia. Edhe pse në parim i takon Paditëses që të vendosë se ndaj kujt dëshiron të parashtrojë padi, Trupi Gjyqësor i DHPGJS-së përmes urdhrit të datës 4 nëntor 2008 e ka ftuar AKP-në si të Paditurën e dytë në procedurën e kësaj lënde. Paditësja duket se nuk e ka kundërshtuar përfshirjen e AKP-së si palë të dytë të paditur në procesin gjyqësor. Andaj, Paditësja së paku në mënyrë të nënkuptuar ka miratuar përfshirjen e AKP-së në procesin gjyqësor si të Paditurën e dytë. Pas kësaj të dy Agjencitë kanë vepruar si të Paditura në procedurën pranë Trupit Gjyqësor të DHPGJS-së.

Çështja se deri në çfarë mase Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit kanë të drejtë të përfaqësojnë Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) në proceset gjyqësore pranë DHPGJS-së është e kontestuar dhe kundërshtuar. Ka precedentë të mëparshëm të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së (ASC-09-0025 etj.) ku Kolegji i Ankesave ka vendosur që AKP-ja mund të përfaqësojë ndonjë NSH-je pranë DHPGJS-së vetëm nëse AKM-ja nuk e ushtron të drejtën e vet për ta bërë një gjë të tillë apo nëse AKM-ja juridikisht nuk ka të drejtë për përfaqësim. Është e kuptueshme se në atë proces gjyqësor në të cilin një NSH është si palë mund të ketë vetëm një përfaqësues të NSH-së, përndryshe nuk do të jetë e mundur të ketë disa përfaqësues që përfaqësojnë mendime të cilat mund të jenë të ndryshme.

Megjithatë, në këtë rast Agjencitë nuk janë duke përfaqësuar ndonjë NSH-je por janë duke vepruar në emër të vetës së tyre. Ngjarjen në të cilat bazohet padia kanë ndodhur kur AKM-ja ende ka qenë përgjegjëse për privatizimin dhe tenderimin e NewCo Jugoterm. Pas zbatimit të Ligjit për AKP-në në vitin 2008, AKP-ja, në vend të AKM-së, faktikisht i ka ndërmarrë masat konkrete lidhur me privatizimin e Ndërmarrjes së Re Jugoterm.

AKP-ja insiston se AKM-ja më nuk është njësi operuese e as ekzistuese. AKM-ja i ka mohuar pretendimet e AKP-së. Vet fakti se AKM-ja vepron si palë në këtë proces gjyqësor dëshmon, edhe pse përfaqësohet nga UNMIK-u, se nuk e ka ndërprerë operimin. AKM-ja ka hequr dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë kundër aktgjyqimit të Trupit Gjyqësor dhe në përgjigjen e saj nuk prezantuar ndonjë kërkesë pran Kolegjit të Ankesave. Trupi Gjyqësor e kishte pranuar AKM-në si të Paditur në procedurë dhe çështja në lidhje me legjitimitetin procedural të AKM-së nuk ka më tej relevancë në Kolegjin e Ankesave.

Sipas nenit 1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr. 03/L-067) AKP-ja është themeluar si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit që rregullohet nga Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12. Në anën tjetër, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i cili përfaqëson UNMIK-un nuk e ka miratuar AKP-në si pasardhëse të AKM-së. Është fakt i ditur se AKP-ja në të vërtetë i ka marrë përsipër në vitin 2008 çështjet dhe përgjegjësitë në lidhje me privatizimin e NSH-ve (me përjashtim të lëndëve me të cilat merret AKM-ja) dhe madje edhe me vazhdimin e procedurave të privatizimit të iniciuara nga AKM-ja. Andaj, AKP-ja ka interes jetik për të marrë pjesë në procese gjyqësore ndonëse ngjarjet në të cilat do të bazohet padia kanë ndodhur para themelimit të AKP-së. Do të ishte shkelje e të drejtave të AKP-së po të mos kishte mundësi të vepronte si palë apo të dëgjohej si e paditur në proceset gjyqësore pranë DHPGJS-së. Përveç kësaj, nuk ka pengesa të tilla për të miratuar të dy Agjencitë si palë në këtë proces gjyqësor.

Ankuesja gjithashtu ka pasoja juridike nga vendimi ndaj të cilit është parashtruar ankesa, meqë është drejtpërdrejtë e obliguar që të veprojë dhe meqë kundërpadia e saj është refuzuar nga Trupi Gjykses (Cf. ASC-09-0035).

Si përfundim, AKP-ja duhet të konsiderohet si kompetente për të vepruar në këtë proces gjyqësor si palë dhe si ankuese para Kolegjit të Ankesave. Si palë në procedurë ajo ka të drejtë të merr qëndrim dhe të veprojë si palë me përgjegjësi të plotë në procedurë duke i përjashtuar vetëm çështjet dhe obligimet që i takojnë vetëm AKM-së.

Afati i fundit për parashtrimin e ankesës

Sipas nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 palët mund të parashtrorjnë ankesa pranë kolegjit të ankesave për ndonjë shqyrtim të aktgjykimeve apo vendimeve brenda tridhjetë ditëve nga pranimi i tyre. Ankuesja e ka marrë aktgjykimin SCC-08-0056 më 17 nëntor 2009 dhe ka parashtruar ankesë brenda tridhjetë ditëve, më 17 dhjetor 2009. Andaj, ankesa është parashtruar me kohë.

Afati kohor për kundërshtimin e veprimeve të Agjencisë

Sipas nenit 6.1. të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 (ndryshuar me Rregulloren 2008/4) "kërkuesi i pagesave mund të bëjë kërkesë për kundërshtimin e një vendimi apo veprimi të Agjencisë brenda nëntë (9) muajve dhe më së voni nga: (a) data kur kërkuesi i tillë ka ditur ose pas përpjekjeve të arsyeshme është dashur të dijë për vendimin apo veprimin e Agjencisë, apo (b) data kur Dhoma e Posaçme njofton publikisht se është në gjendje t'i pranojë kërkesat."

Ankuesja në këtë rast ka parashtruar padi pranë DHPGJS-së më 3 mars 2008. Padiësja është informuar nga AKM-ja rreth anulimit të tenderit përmes një letre të datës 2 gusht 2006. Megjithatë, Padiësja ka kërkuar nga AKM-ja që të paraqesë vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKM-së që ka të bëjë me anulimin e tenderit. E Paditura e parë ka

VIII

pranuar se anulimi i tenderit të privatizimit pa miratimin e Bordit të Drejtorëve të AKM-së është i pavlefshëm.

Më 24 qershor 2009 AKM-ja ka paraqitur tek Trupi Gjykses i DHPGJS-së një kopje të procesverbalit të një takimi të bordit të drejtorëve të AKM-së, të datës 21 shtator 2006. Nga procesverbali mund të shihet se Bordi i Drejtorëve e ka refuzuar propozimit për anulimin e tenderit dhe përjashtimin e Padiësës nga çdo tender i ardhshëm. Padiësja është informuar, si dhe ka marrë një kopje të atij vendimi të Bordit të Drejtorëve vetëm atëherë kur AKM-ja e ka dorëzuar kopjen tek Trupi Gjykses. Edhe pse Padiësja e ka pranuar letrën e AKM-së të datës 2 gusht 2006 me informatat rreth anulimit të tenderit të Padiësës, përmbajtja e letrës ka qenë joadekuate dhe Padiësja i ka marrë informatat e duhura rreth vendimit tejet të rëndësishëm dhe veprimeve të AKM-së vetëm në qershor 2009. Afati i fundit duhet të llogaritet vetëm nga koha kur Padiësja i ka marrë informatat rreth vendimit gjë që ka ndodhur pas paraqitjes së padisë pranë DHPGJS-së. Andaj, padia sipas nenit 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 (2008/4) nuk është paraqitur pas kohës.

Pretendimet res judicata

Ankuesja gjithashtu pohon se kontesti i kësaj lënde është vendosur përfundimisht më 8 gusht 2007 (*res judicata*) me aktgjykimin e Trupit Gjykses të DHPGJS-së SCC-06-0475. Një kopje e aktgjykimit është dorëzuar pranë Kolegjit të Ankesave.

Në lëndën SCC-06-0475, Padiës ka qenë Shefquet Aliu dhe e Paditur Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Padiësi ka kërkuar nga DHPGJS-ja që të anulohë shpalljen e ENG Office nga Gjilani si fitues të tenderit për privatizimin e ndërmarrjes publike Jugoterm si dhe ritenderimin e ndërmarrjes. Padiësi ka shpjeguar se para tenderimit padiësi kishte lidhur marrëveshje të fshehtë lidhur me tenderimin me palë të tjera. Sipas marrëveshjes, nëse njëra nga palët do të përzgjidhej, palët e tjera do të kontribuonin në çmimin e shitjes së ndërmarrjes.

Trupi Gjykses i DHPGJS-së e ka miratuar pjesërisht padinë e Shefqet Aliut dhe në dispozitiv të aktgjykimit shkruan: "*Padia e paditësit miratohet pjesërisht dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit obligohet që të anulojë tenderin që i është dhënë ndërmarrjes publike Eng Office në Gjilan për shitjen e ndërmarrjes publike Jugoterm.*" Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit Trupi Gjykses pohon se ka dëshmi dokumentuese se ka pasur marrëveshje të fshehtë mes disa palëve dhe se ajo marrëveshje e fshehtë është kundër politikave të operimit të AKM-së. Andaj, Trupi Gjykses arrin në përfundim se AKM-ja ka pasur të drejtë të shpallë të pavlefshëm tenderin.

Paditësja e kësaj lënde ENG Office SHPK ka parashtruar në DHPGJS një kërkesë për shqyrtimin e aktgjykimit të lëndës SCC-06-0475. DHPGJS-ja me vendimin e datës 5 shkurt 2008 e ka refuzuar kërkesën e ENG Office SHPK për rishqyrtim.

Për sa i përket pretendimit për *res judicata* të Ankueses, Kolegji i Ankesave së pari vërteton se Paditësja e këtij procesi gjyqësor ENG Office SHPK nuk ka qenë palë i procesit gjyqësor të mëparshëm të lëndës SCC-06-0475 dhe se nuk është dëgjuar fare në procesin gjyqësor të lëndës edhe pse rezultati i procesit gjyqësor formalisht do të kishte ndikim të madh mbi statusin e kompanisë. Edhe pse ENG Office SHPK më vonë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e aktgjykimit të lëndës SCC-06-0475 nuk do të thotë se ENG Office SHPK në rastin e mëparshëm ka pasur mundësi dhe mënyra të ngjashme për të proceduar si palët e para të lëndës. Kërkesa për shqyrtimin e ndonjë aktgjykimi në esencë duhet të konsiderohet si masë e jashtëzakonshme.

Megjithatë, vet substanca e proceseve gjyqësore të mëparshme dhe të tanishme në parim është e njëjtë, edhe pse paditë kanë qenë kundërshtuese për nga natyra. Pasi që aktgjykimi i DHPGJS-së me të cilin DHPGJS-ja e ka anuluar tenderimin e AKM-së, mund të shtrohet pyetja se nëse gjykata do të lejohej që të jepte në ndonjë lëndë tjetër

ndonjë zgjidhje që do të miratonte tenderin dhe të konfirmonte ofertuesin fitues të tenderimit të mëparshëm. Për shkak të faktit se Padiësja e lëndës në fjalë nuk ka qenë palë e procesit gjyqësor të mëparshëm dhe meqë kompania nuk i ka pasur mundësitë e rregullta për të prezantuar dëshmi që e mbështesin qëndrimin e saj dhe të përdorë mjetet e zakonshme që janë në dispozicion të palës në procedurë, nga këto çështje plotësisht procedurale duhet të nxirret përfundimi se aktgjykimi i mëparshëm nuk mund të parandalojë shqyrtimin e padisë së Padiësës ENG Office SHPK.

Ankuesja në ankesë ka kërkuar që vetëm arsyet formale dhe procedurale të trajtohen ndarazi (mospërputhja me afatin kohor dhe res judicata) pa asnjë pretendim lidhur me procesin material të tenderimit dhe të metat e mundshme të saj. Prandaj, Kolegji i Ankesave arrin në përfundim se pretendimet rreth shkeljes së të drejtave procedurale nuk janë të pabazuara dhe se aktgjykimi i Trupit Gjyqësor duhet të vërtetohet.

Shpenzimet e gjykatës

Sipas jurisprudencës së përhershme të Kolegjit të Ankesave, Ankuesja lirohet nga shpenzimet e gjykatës.

U vendos nga Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së më 7 tetor 2011:

Tapio Vanamo, Gjyqtar i EULEX-it	nënshkrimi
Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it	nënshkrimi
Mr. Sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar	nënshkrimi
Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it	nënshkrimi